


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori IV, 2023

Tiranë, më 05 Mars 2024: Në tremujorin e katërt të vitit 2023, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 131,6 kundrejt vitit 2020. Krahasuar me tremujorin e katërt 2022 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit shënoi një rritje me 3,1 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 21,4 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në tremujorin e katërt 2023 shënoi rritje me 0,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2023.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit



Ndryshimi vjetor: Krahasuar me tremujorin e katërt 2022 rritja më e madhe e çmimeve prej 7,5 % vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar”, pasuar nga seksionet, “Industri nxjerrëse”, me 4,5 %, “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 1,7 % dhe “Industri përpunuese” me 1,5 %. Brenda seksionit “Industri përpunuese” rritja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 5,8 %, pasuar nga aktivitetet “Prodhimi i pijeve” me 4,5 %, “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 4,4 %, “Prodhimi i mobiljeve” me 3,4 %, “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” me 3,3 %, etj. Nga ana tjetër, ulja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin “Përpunimi i tekstileve” me 4,7 %, pasuar nga “Prodhimi i pajisjeve elektrike” me 3,3 %, “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 3,2 %, Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike” me 1,5 %, etj.

Për publikim 05/03/2024

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas: Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2022, indeksi shënoi rritje me 4,2 %. Rritja më e madhe e çmimeve vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 11,0 %, pasuar nga seksionet “Industri nxjerrëse” me 6,4 %, “Industria Përpunuese” me 1,9 % dhe “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,2 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport: Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2022, indeksi shënoi rritje prej 1,1 %. Rritja më e madhe e çmimeve është shënuar në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 14,0 %, pasuar nga seksioni “Industria Përpunuese” me 1,1 %. Nga ana tjetër, seksioni “Industri Nxjerrëse” ka shënuar ulje me 1,1 %, pasuar nga seksioni “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” me 1,0 %.

Ndryshimi tremujor: Krahasuar me tremujorin e tretë 2023, rritja më e madhe prej 0,9 % vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar”, pasuar nga seksionet “Industri Nxjerrëse” me 0,6 %, “Industri Përpunuese” me 0,1 %. Brenda këtij seksioni rritja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetet “Prodhimi i pijeve” me 1,8 %, pasuar nga aktivitetet “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 1,6 %, “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve” me 1,5 % etj.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas: Krahasuar me tremujorin e tretë 2023, indeksi shënoi rritje me 0,4 %. Rritja më e madhe vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 1,2 %, pasuar nga seksionet “Industri Nxjerrëse” dhe “Industria Përpunuese” përkatësisht me 0,1 % secila. Nga ana tjetër seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” ka shënuar ulje me 0,1 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport: Krahasuar me tremujorin paraardhës indeksi shënoi rritje me 0,3 %. Rritja më e madhe vërehet në seksionin “Industri Nxjerrëse” me 1,5 %, pasuar nga seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,8 % dhe “Industria Përpunuese” me 0,1 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2020=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	10-23	11-23	12-23	IV-23	IV-23 /III-23	IV-23 /IV-22
	Gjithsej	100,0	131,6	131,6	131,5	131,6	0,3	3,1
B	Industri Nxjerrëse	11,3	157,5	157,1	157,1	157,2	0,6	4,5
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	4,4	191,0	191,0	191,0	191,0	3,5	8,3
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,9	154,8	154,1	154,0	154,3	-1,3	2,2
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,9	128,1	128,0	128,0	128,1	0,3	2,8
C	Industri Përpunuese	58,8	124,9	124,9	124,8	124,9	0,1	1,5
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	8,0	140,8	141,4	141,4	141,2	1,0	5,8
11	Prodhimi i pijeve	1,6	124,4	124,2	124,3	124,3	1,8	4,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,0	104,3	104,3	104,3	104,3	1,6	4,4
13	Përpunimi i tekstileve	0,7	97,7	97,7	97,7	97,7	0,1	-4,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,9	106,4	106,4	106,4	106,4	-0,5	0,1
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	3,9	110,0	109,9	110,0	110,0	0,0	1,5
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,3	129,6	129,7	129,6	129,6	1,5	2,3
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0,8	114,8	114,8	114,8	114,8	0,1	-0,1
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	2,7	125,6	125,6	125,6	125,6	0,3	2,5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,7	122,6	122,6	122,6	122,6	-0,5	-3,2
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,2	131,1	131,2	131,2	131,2	-0,4	-1,5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1,1	125,0	125,0	125,0	125,0	0,4	1,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,4	121,5	121,5	121,5	121,5	0,4	-1,3
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	8,2	140,6	140,0	139,4	140,0	-1,1	-1,3
24	Metalurgjia	10,2	127,9	128,0	127,9	127,9	0,0	0,9
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,9	137,5	137,6	137,6	137,6	0,1	3,3
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,3	97,8	97,8	97,8	97,8	-0,1	-1,4
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	1,2	99,3	99,3	99,3	99,3	0,1	-3,3
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,6	102,2	102,2	102,2	102,2	0,0	-0,4
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,4	93,8	93,8	93,8	93,8	-0,7	-1,3
30	Pajisje të tjera transporti	0,1	126,4	126,4	126,4	126,4	0,5	0,3
31	Prodhimi i mobiljeve	5,1	121,6	121,5	120,9	121,3	0,1	3,4
32	Industri të tjera p.k.t	0,3	104,5	104,5	104,5	104,5	-0,2	0,4
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	108,1	108,1	108,1	108,1	0,0	1,5
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	20,5	152,8	152,8	152,8	152,8	0,9	7,5
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	20,5	152,8	152,8	152,8	152,8	0,9	7,5
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	9,4	105,5	105,4	105,4	105,5	0,0	1,7
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	6,8	100,6	100,6	100,6	100,6	0,0	0,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,7	137,0	136,5	136,6	136,7	0,1	6,0

Tab. 2 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

2020=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	10-23	11-23	12-23	IV-23	VI-23 / III-23	IV-23/IV-22
	Gjithsej	100,0	129,3	129,3	129,3	129,3	0,4	4,2
B	Industri Nxjerrëse	9,3	153,9	153,9	153,9	153,9	0,1	6,4
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	2,2	180,9	180,9	180,9	180,9	3,5	13,4
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	6,0	159,0	159,0	159,0	159,0	-1,4	4,2
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,1	127,4	127,4	127,4	127,4	0,6	3,3
C	Industri Përpunuese	54,6	133,8	133,8	133,8	133,8	0,1	1,9
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	8,5	148,5	148,5	148,5	148,5	1,0	6,4
11	Prodhimi i pijeve	2,2	124,2	124,2	124,2	124,2	1,9	5,2
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	104,7	104,7	104,7	104,7	1,6	4,7
13	Përpunimi i tekstileve	0,4	120,8	120,8	120,8	120,8	-0,1	-0,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	0,1	106,2	106,2	106,2	106,2	-0,2	0,8
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	1,3	110,6	110,6	110,6	110,6	-1,9	-3,1
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,4	132,9	132,9	132,9	132,9	1,2	2,1
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0,1	122,1	122,1	122,1	122,1	0,8	3,1
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	4,3	125,6	125,6	125,6	125,6	0,3	2,5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,2	153,6	153,6	153,6	153,6	-0,1	0,6
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,8	138,1	138,1	138,1	138,1	0,0	-0,2
21	Përpunimi i produkteve farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	1,7	126,6	126,6	126,6	126,6	0,4	1,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,4	128,8	128,8	128,8	128,8	1,1	0,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	10,1	137,6	137,6	137,6	137,6	-1,2	-1,5
24	Metalurgjia	8,7	140,6	140,6	140,6	140,6	0,2	0,7
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,1	137,6	137,6	137,6	137,6	0,0	1,8
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,2	96,0	96,0	96,0	96,0	0,5	-0,2
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,2	100,2	100,2	100,2	100,2	0,3	0,0
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,5	108,8	108,8	108,8	108,8	-0,1	-0,9
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0,1	92,1	92,1	92,1	92,1	-0,5	-1,4
30	Pajisje të tjera transporti	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	7,0	121,6	121,6	121,6	121,6	0,2	3,5
32	Industri të tjera p.k.t	0,3	114,2	114,2	114,2	114,2	1,0	3,2
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,2	108,1	108,1	108,1	108,1	0,0	1,5
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	22,8	128,6	128,6	128,6	128,6	1,2	11,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	22,8	128,6	128,6	128,6	128,6	1,2	11,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	13,2	101,1	101,1	101,1	101,1	-0,1	0,2
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	10,7	100,6	100,6	100,6	100,6	0,0	0,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,6	101,7	101,7	101,7	101,7	-0,3	0,4

Tab. 3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

2020=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	10-23	11-23	1223	VI-23	IV-23/ III-23	IV-23/IV-22
	Gjithsej	100,0	141,5	141,6	141,5	141,5	0,3	1,1
B	Industria Nxjerrëse	14,7	166,1	165,9	165,5	165,8	1,5	-1,1
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	8,3	192,4	192,4	192,4	192,4	3,6	0,5
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,8	158,2	157,8	157,1	157,7	-0,7	-0,3
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,6	128,1	128,1	128,1	128,1	-0,4	1,2
C	Industria Përpunuese	65,9	114,2	114,3	114,3	114,3	0,1	1,1
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	7,2	122,0	123,2	123,2	122,8	0,7	4,5
11	Prodhimi i pijeve	0,6	128,5	128,5	128,5	128,5	1,4	1,4
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,0	99,8	99,8	99,8	99,8	0,8	0,2
13	Përpunimi i tekstileve	1,2	91,2	91,2	91,2	91,2	0,1	-7,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	10,5	106,5	106,5	106,5	106,5	-0,5	0,1
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	8,4	110,3	110,2	110,3	110,2	0,5	2,1
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,1	126,0	126,4	126,1	126,2	2,2	2,9
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2,2	113,9	113,9	113,9	113,9	0,1	-0,2
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,5	120,6	120,6	120,6	120,6	-0,6	-3,6
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,9	123,0	123,0	123,0	123,0	-0,7	-1,9
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,1	105,6	105,6	105,6	105,6	0,0	1,4
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,3	110,1	110,1	110,1	110,1	-1,0	-4,0
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	4,9	167,8	167,8	167,8	167,8	1,3	1,2
24	Metallurgjia	12,8	115,9	116,0	115,9	116,0	-0,2	1,1
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,7	134,9	134,9	134,9	134,9	0,3	6,0
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,7	98,2	98,2	98,2	98,2	-0,3	-2,5
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	3,0	99,1	99,1	99,1	99,1	0,1	-3,5
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t	0,8	102,1	102,1	102,1	102,1	0,3	0,1
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,8	94,0	94,0	94,0	94,0	-0,8	-1,3
30	Paisje të tjera transporti	0,2	129,9	129,9	129,9	129,9	0,6	0,4
31	Prodhimi i mobiljeve	1,8	123,4	123,5	123,5	123,4	0,7	4,3
32	Industri të tjera p,k,t	0,4	101,5	101,5	101,5	101,5	-1,4	-2,4
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	16,5	401,3	401,3	401,3	401,3	0,0	-1,0
35	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	16,5	401,3	401,3	401,3	401,3	0,0	-1,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,9	167,7	166,2	166,7	166,8	0,8	14,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,9	167,7	166,2	166,7	166,8	0,8	14,0

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri nxjerrëse

Seksioni C – Industri përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar

Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i kampionit të ndërmarrjeve dhe shportës së produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i parë 2021 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2020 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{2020}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=2020}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2020 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2020 (2020 = 100).
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2020 deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhje e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.